

THIRRJE E HAPUR për Fasilitator të kampit të trajnimit AKADEMIA për nxënës të shkollave të mesme për vullnetarizëm dhe aktivizëm

1. Sfondi

Projekti "Të Rinjtë - Agjentët e Ndryshimit", financuar nga Bashkimi Evropian, zbatohet nga Qendra për Dialog Interkulturore në partneritet me Unionin e Skautëve të Maqedonisë dhe NOVUS - Strumicë. I trajton iniciativat rinore, aktivizmin dhe vullnetarizmin si një nga parakushtet kyçe për përmirësimin e demokracisë dhe pjesëmarrjes së qeverisjes vendore, si dhe forcimin dhe gjithëpërfshirjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në proceset demokratike në nivel lokal.

Projekti synon të rrisë aktivizmin rinor përmes vullnetarizmit për të siguruar gjithëpërfshirje sociale dhe zhvillim të komuniteteve lokale. Përdoruesit përfundimtarë të projektit janë nxënës të shkollave të mesme, studentë, aktivistë rinorë, të rinj, femra, të rinj me aftësi të kufizuara, iniciativa rinore, këshillat rinorë lokalë dhe anëtarë të komuniteteve lokale të komunave të: Qendrës, Kumanovës dhe Strumicës si komunat e synuara primare dhe 7 komuna dytësore të synuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Objektivat specifike të projektit:

- Të forcohen rrjetet joformale të aktivistëve dhe vullnetarëve të rinj, për kapacitetet e tyre në terren ndaj autoriteteve vendore dhe qytetarëve, si dhe në kapacitetet e tyre monitoruese dhe avokuese.
- Të ndërtohet një sistem i qëndrueshëm arsimor në shkollat e mesme për forcimin dhe inkurajimin e të rinjve dhe aktivizmin rinor për kapacitetet e tyre në terren ndaj pushteteve vendore dhe qytetarëve, si dhe në kapacitetet e tyre monitoruese dhe avokuese.

Aktivitetet e projektit synojnë arritjen e katër rezultateve kryesore:

- Krijimi i mekanizmit për bashkëpunimin e aktivistëve dhe vullnetarëve të rinj me komunat "miq të vullnetarëve" në procesin e sjelljes së ndryshimeve pozitive.
- Zhvillimi i kompetencave dhe aftësive të mësuesve të shkollave të mesme përmes krijimit të programeve për aktivizmin rinor në nivel lokal përmes arsimit joformal
- Të rinjë me shkathtësi të fituara për të vepruar në institucionet vendore drejtpërdrejt dhe përmes këshillave rinore lokale
- Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e iniciativave rinore, aktivizmit dhe vullnetarizmit në nivel lokal

Projekti ka filluar të zbatohet në mars 2022 dhe pritet të përfundojë në gusht 2024.

2. Rreth Akademisë për Vullnetarizëm dhe Aktivizëm

Akademia për Vullnetarizëm dhe Aktivizëm është një kamp trajnimi i dedikuar për nxënësit e shkollave të mesme të cilët gjatë 7 ditëve do të fitojnë aftësi për të vepruar në nivel lokal, bashkëpunim me institucionet vendore dhe pjesëmarrje në punën e këshillave rinore lokale.

Akademia do të shërbejë për rrjetëzimin e të rinjve nga të njëjtat rajone në proceset e përfaqësimit para komunave, për promovimin e shkrim-leximit digjital, mësimin ndërkulturor, arsimin profesional, të menduarit kritik, kuptimin e gjithëpërfshirjes dhe diversitetit dhe promovimin e vlerave të solidaritetit, mundësitë e barabarta dhe të drejtat e njeriut mes të rinjve.

Gjatë akademisë, të rinjtë do të kenë mundësinë të diskutojnë se si, kur dhe me ndihmën e kujt mund të bëjnë një ndryshim në nivel lokal. Ata do të mësojnë nga shembujt dhe projektet reale të aktivistëve me përvojë nga Maqedonia e Veriut dhe rajoni.

Akademia do të realizohet në hapësirë të hapur, përmes një metodologjie kampi me edukim në natyrë, duke punuar sipas parimeve dhe vlerave të skautizmit, të cilat kontribuojnë në ndërtimin e individëve që arrijnë potencialin e tyre të plotë. Kampi do të përfshijë 100 pjesëmarrës nga 10 komuna dhe do të zgjasë nga **15 deri më 22 gusht**.

Pjesa programore do të përbëhet nga paketa të ndryshme arsimore të përbërë nga një sërë sesionesh që përfshijnë vullnetarizmin, aktivizmin, pjesëmarrjen e të rinjve në nivel lokal/nacional/rajonar, legjislacionin për të rinjtë, palët e interesuara rinore, programet rinore, rrjetëzimin dhe punën me projekte. Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të krijojnë në mënyrë të pavarur rrugën e tyre arsimore sipas interesave dhe qëllimeve të tyre. Të ndihmuar nga aktivistë të cilët do të përcjellin përvojën dhe njohuritë e tyre në mënyrë tërheqëse dhe interaktive, ato premtojnë një përvojë unike arsimore.

Pjesëmarrësit e akademisë do të kenë mundësinë që në periudhën e ardhshme të përfshihen në rrjetet lokale joformale të "agjentëve të ndryshimit" dhe së bashku me kolegët e tyre të jenë bartës të vërtetë të ndryshimeve pozitive duke organizuar dhe zbatuar projekte mikro dhe të vogla të financuara nga Bashkimi Europian.

3. Qëllimet e thirrjes

Qëllimi i kësaj thirrje është të ftojë individë të interesuar në fushën e aktivizmit, vullnetarizmit dhe politikave rinore për të lehtësuar grupet në zbatimin e një programi edukativ dhe tërheqës për të rinjtë bazuar në konceptin e zhvilluar nga ekipi i partnerëve dhe lehtësuesve/fasilitatorëve të akademisë.

Numri i fasilitatorëve të kërkuar është **7 (shtatë)**. Kandidatët e interesuar aplikojnë individualisht.

Angazhimi i fasilitatorëve përfshin:

- **Takime përgatitore me ekipin e partnerëve dhe trajnerët e akademisë në periudhën 05.08 - 10.08.2022**
- **Fasilitimi i një grupi të rinjsh dhe puna në grupe të vogla sipas tematikës së Akademisë**

- **Përgatitja e një raporti për punën e bërë jo më vonë se 31.09.2022 (tekst i shkurtër për përvojën nga akademia dhe punën me të rinjtë)**

4. Akomodimi dhe ushqimi

Akomodimi i fasilitatorëve është në tenda pranë liqenit të Ohrit në Qendrën e Skautsave Ohër. Ushqimi është në një kuzhinë qendrore dhe përfshin 3 vakte në ditë, ushqim dhe pije freskuese.

5. Kompensimi për angazhimin e punës

Për secilin nga fasilitatorët është paraparë kompensim i njëhershëm prej **100 euro bruto** në denarë. Fondet do t'u paguhen jo më vonë se 7 ditë nga dita e dërgimit të raportit dhe plotësimit të formulës.

6. Profili i fasilitatorëve

Fasilitatorët janë të rinj aktivë me të paktën **2 vjet përvojë vullnetare** në fushën e aktivizmit rinor, vullnetarizmit dhe politikave rinore. Fasilitatorët kanë përvojë të dëshmuar vullnetare në organizata rinore, me pjesëmarrje në një numër të madh programesh rinore brenda dhe jashtë tij (programi Erasmus dhe të ngjashme).

7. Procedura për aplikim

Regjistrimi i kandidatëve të interesuar bëhet duke dërguar:

- **CV nga Fasilitatori me përvojë të deklaruar vullnetare dhe/ose profesionale**
- **Lista e referencës së projekteve/programeve në të cilat ka marrë pjesë**
- **Motivimi për të marrë pjesë si fasilitatorë trajnimi (deri në 300 fjalë)**

Afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve të kërkuara është **29.07.2022** në sim@scout.org.mk

Organizatori rezervon të drejtën gjatë përzgjedhjes së kandidatëve të kërkojë dokumentacion shtesë për të vërtetuar përvojën e paraqitur.

Pyetje?

Nëse keni pyetje në lidhje me akademinë ose procesin e aplikimit, mund të na kontaktoni në sim@scout.org.mk ose info@cid.mk